



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 36
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 15 shkurt 2019, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Drita Millaku, Haxhi Avdyli, Fikrim Damnka dhe Naser Rugova.

Munguan: Miljana Nikoliq, Enver Hoti dhe Time Kadrijaj.

I ftuar: z.Uran Ismaili, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë.

Pjesëmarrës tjerë: Ardita Baraku dhe Isak Shabani nga Ministria e Shëndetësisë.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

RENDI I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Uran Ismaili**
 - Licencimi i institucioneve private shëndetësore;
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Uran Ismaili

- Licencimi i institucioneve private shëndetësore.

Besa Baftiu tha se përshëndes ministrin dhe e falënderoj që ju ka përgjigjur ftesës. Qëllim i këtij takimi është që të trajtojmë licencimin e institucioneve private shëndetësore, duke pasur parasysh rastin e fundit që ndodhi në Drenas, e ku ishin të përfshira shumë institucione si institucioni i

arsimit, pastaj i sigurisë, drejtësisë si dhe i shëndetësisë. E dimë që ndoshta përgjegjësia e Ministrisë së Shëndetësisë nuk është e drejtpërdrejtë, por përgjegjësia bie pikërisht te rasti i mos licencimit të institucionit shëndetësor ku është kryer aborti. Ne e dimë që abortet duhet të kryhen te institucionet të cilat i plotësojnë kushtet ligjore e mos të kryhet në institucionet që nuk i plotësojnë kushtet dhe e rrezikojnë jetën e pacientëve. Gjithashtu edhe licencimi i institucioneve shëndetësore publike nuk ka ndodhur që nga paslufta dhe kjo është në kundërshtim me Ligjin e Shëndetësisë i cili parashihet licencimin e të gjitha institucioneve shëndetësore si publike ashtu edhe private.

Numri i institucioneve private shëndetësore është shumë i madh diku rreth 1300 institucione, a po arrin Inspektorati Shëndetësor me këtë numër kaq të vogël të inspektorëve, të inspektoj të gjitha këto institucione dhe cili është plani i ministrisë që të rregulloj këtë fushë ?

Uran Ismaili tha se rasti i Drenasit ka qenë një rast që e ka prekur vetë ndërgjegjen e shoqërisë dhe ka prekur hallka të rëndësishme të shtetit. Ne, përveç dhimbjes, kemi edhe obligime shtesë që të dalim me politika konkrete në mënyrë që asnjë e mitur tjetër të mos kaloj këto përvoja të hidhura.

Sa i përket licencimit të institucioneve private shëndetësore, në Kosovë ka një numër të madh të institucioneve private shëndetësore të licencuara rreth 1606 institucione, prej të cilave 28 janë institucione spitalore. Sektori privat shëndetësor rregullohet, mbikëqyret dhe kontrollohet nga Ministria e Shëndetësisë. Udhëzimi administrativ 08/2014 rregullon mënyrën e licencimit të institucioneve private shëndetësore. Brenda ministrisë kemi Bordin për licencimin e institucioneve private shëndetësore. Ky bord ka edhe komisione vlerësuese regjionale.

Licenca e një institucioni privat shëndetësor është me afat 5 vjeçar dhe obligimi për ri licencim bie mbi vetë institucionin shëndetësor që e ka kërkuar licencën, e jo mbi institucionet e Ministrisë së Shëndetësisë. Në rastin e Drenasit kemi pasur një ambulancë e cila nuk ka qenë e licencuar ndërsa sipas ligjit institucioni privat shëndetësor duhet që dy muaj para se t'i kalojë licenca të aplikojë për ri licencim, nëse institucioni dëshiron ta vazhdoj veprimtarin . Pra nuk është obligim i Inspektoratit t'i detyrojë institucionet shëndetësore të licencohen.

Ambulanca ku dyshohet që është kryer aborti i të miturës nga Drenasi, pra ambulancës „Kestrina” i ka skaduar licenca në korrik të vitit 2018, dhe nuk kanë aplikuar për ri licencim. Mjeku dr. Fehmi Ahmet ka pasur licencë, por institucioni ku dyshohet që është kryer aborti nuk ka pasur licencë. Po ashtu për abort duhet të plotësohen disa kushte si parashihen me ligj, e të cilat kushte ambulanca „Kestrina” nuk i ka plotësuar, dhe ka rrezikuar shëndetin e placentës dhe ka shkelur ligjin. Inspektorati shëndetësor reagon në çdo kohë kur kupton apo kur inspekton dhe e nxënë dikë duke punuar pa licencë.

Sa i përket rastit të Drenasit, kanë filluar edhe hetimet brenda Odës së mjekëve për shkeljet që kanë ndodhur nga mjeku në fjalë. Rasti Drenasit tregon rëndësin e licencimit të institucioneve private, dhe kjo të jetë si mesazh për të gjitha institucionet private shëndetësore që duhet t'i plotësojnë kushtet ligjore dhe të licencohen për të operuar.

Sa i përket punës së Inspektoratit Shëndetësor, janë 10 inspektorë shëndetësorë dhe për vitin e ardhshëm presim që numri i inspektorëve shëndetësorë të dyfishohet. Ju kemi krijuar edhe kushte më të mira të punës. Duke rritur kapacitetin e Inspektoratit Shëndetësor rrisim edhe kontrollin mbi institucionet shëndetësore, por obligimi i institucioneve private shëndetësore është kur t'ju kalon licenca të aplikojnë për ri licencim, e jo të presin a po ju shkon në kontroll inspektorati shëndetësor.

Haxhi Avdyli tha se fillimisht kisha filluar me atë që Ligji i pagave ka favorizuar në masë të madhe disa institucione për mbrojtjen e ligjshmërisë si janë prokurorët dhe gjyqtarët, ndërsa në anën tjetër institucionet që janë të thirrura për mbrojtjen e ligjshmërisë në institucione

shëndetësore, siç janë inspektorati shëndetësor, i ka diskriminuar dhe i ka lënë me kuota shumë të ulëta. Me këto paga shumë të ulëta në anën tjetër po kërkohet të rrisin kapacitetin e punës dhe mbikëqyrjen dhe të punojnë edhe jashtë orarit të punës e të mos paguhen, mendoj se nuk ka shpresa për sukses nëse nuk i përkrahim dhe nuk gjejmë mënyra ti përkrahim si Inspektoratin shëndetësor ashtu edhe Inspektoratin farmaceutik.

Sa i përket monitorimit dhe inspektimeve të Inspektoratit shëndetësor u pa se ata më shumë kanë inspektime në institucione private shëndetësore sesa në institucione publike, e duke pasur parasysh që institucionet publike nuk janë të licencuara atëherë mendoj se duhet të shtohet monitorimi edhe ndaj institucioneve publike, se edhe aty ka shkelje.

Një çështje tjetër është se ju si ministri nuk keni punuar sa duhet në hartimin e legjislacionit dhe akteve nënligjore shumë të domosdoshme për reformën në shëndetësi.

Fatmire Mulhaxha – Kollçaku tha se rasti i Drenasit ka qenë vetëm shkas për ta hapur një temë kaq të rëndësishme dhe se këtë duhet ta trajtojmë si një fenomen që të gjithë duhet të angazhohemi.

Sa i përket licencimit të institucioneve shëndetësore kemi lëvizje në licencim të institucioneve private shëndetësore, por kemi ngecje apo dështim total në licencim të institucioneve publike shëndetësore. Fokusimi i Ministrisë së Shëndetësisë duhet të jetë te fillimi i licencimit të institucioneve publike dhe rritjen e mbikëqyrjes ndaj institucioneve shëndetësore private, si dhe ta rishikojmë legjislacionin. E dimë që barra nuk bie mbi Inspektoratin shëndetësor që t'i lajmëroj institucionet privatë shëndetësore se ju ka skaduar licenca por ndoshta është mirë të mendohet që të gjendet një metodë të paralajmërohen se po ju skadon licenca.

Ju inkurajoj në rritjen e numrit të inspektorëve, por mendoj që keni pengesa pasi me ligj kërkohet që inspektori të jetë mjek dhe me kushtet që i kanë, dhe të nënvlerësuar në pagë, nuk mendoj që do të keni kandidat që do të konkurrojnë për inspektor. Inspektoratin shëndetësor duhet ta përkrahni edhe ne do ju mbështesim, dhe sa më shpejt ta sjellin për miratim edhe Ligjin për inspektoratin shëndetësor, i cili do e rregullonte edhe statutin e tyre.

Sa i përket abortit të paligjshëm kjo po ndodh, dhe është një fenomen. Ne duhet të investojmë në parandalim dhe në informim shëndetësor, e sidomos te të rinjtë.

Gjithashtu ai institucion që nuk ka kushte t'i trajtojë komplikimet e abortit nuk mund ta kryej.

Fuqizimi i Inspektoratit Shëndetësor do të vendos rregullsi dhe do të mbyllet të gjitha institucionet që nuk i plotësojnë kushtet.

Naser Rugova theksoi se rasti nga Drenasi prek ndërgjegjen institucionale dhe hallkat e shtetit duhet të veprojnë. Ne sot po diskutojmë për hallkën e shëndetësisë e cila dështoi.

Inspektorati shëndetësor dhe farmaceutik duhet të fuqizohen dhe ky fuqizim duhet të bëhet me ligj dhe me akte nënligjore. Aktet nënligjore duhet të hartohen në mënyrë profesionale.

Tema e abortit duhet të diskutohet dhe duhet të merren masa të parandalimit.

Inspektorati shëndetësor duhet ta detektojë gjendjen dhe me një program të caktuar atyre që ju skadon licenca, duhet t'ju drejtojë një email apo sms dhe t'i njoftojë se ju ka kaluar licenca.

Mendoj që një monitorim i cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe shkeljeve të mundshme duhet t'u bëhet edhe institucioneve publike shëndetësore.

Flora Brovina tha se rasti i Drenasit ka qenë shumë shqetësues dhe janë shkelur shumë ligje. Së pari dështimi i rolit të prindit, edukatorit, organeve të sigurisë e pastaj edhe i mjekut.

Mendoj që shkollat duhet të luajnë një rol më të madh në edukimin shëndetësor të fëmijëve, e këtë rol duhet ta luajë mjeku shkollor, e që te ne nuk ekziston. Është koha që në shkolla të kemi mjek shkollor, që të rinjtë do të konsultoheshin me këta mjek. Do të insistoj që në ndryshimet e Ligjit për shëndetësi të përfshihet dhe t'i kushtohet më shumë rëndësi preventivës.

Sa i përket ordinancave private sidomos atyre gjinekologjike, mendoj se ato nuk e zbatojnë plotësisht ligjin dhe kontrolli është i pamjaftueshëm. Nuk raportohet numri i saktë i aborteve të cilat i kryejnë dhe shumica nuk i plotësojnë kushtet për abort, e ku në këto ordianca kryhen abortet më të ndjeshme të të miturave, e ndodhin edhe aborte selektive, që janë të pa pranueshme. Duhet të ketë kontrolle më të shpeshta në këto ordianca.

Drita Millaku tha se diskriminimi që i është bërë inspektorëve shëndetësor në Ligjin e pagave ndikon edhe në punën e inspektoratit dhe besoj se edhe në të ardhmen do ketë vështirësi në kryerjen e detyrave të tyre.

Sa i përket licencimit të institucioneve private shëndetësore unë e kam një shqetësim të veçanta lidhur me nenin 20 të Ligjit për shëndetësi i cili u mundëson komunave serbe që të japin licencë për institucionet private shëndetësore që nuk është në rregull dhe duhet të ndryshohet. Kjo është bërë me qëllim që sistemi sekondar shëndetësor në komunat serbe të ndahet nga pjesët tjera.

Pyetje tjetër është se pse nuk është revokuar licenca e spitalit IHM, një spital turk për kardiologji ku dihet se ka pasur keqpërdorime të mëdha që nga paslufta. Këta thirren që e kanë ndërruar pronarin, por prapë vazhdojnë me keqpërdorime.

Pyetja e tretë, pse i është dhënë licenca për punë institucionit privat „Aloka”, përsëri një shtetasi turk, dr. Mahmut Çakmak, pavarësisht që është i implikuar drejtpërdrejt në rastin stenda. Ky person nuk duhet të punojë kur ende nuk është dënuar për keqpërdorimet e bëra.

Pra, Ligji për shëndetësi duhet të ndryshohet urgjentisht.

Bekim Haxhiu tha se ju kemi ftuar ministër të bashkëbisedojmë për rastin e vajzës nga Drenasi e cila u abuzua nga ata të cilët duhet ta mbronin. Ky rast ka vu në pah një parregullsitë të madhe të funksionimi i institucioneve private shëndetësore, ku humanisti ka bërë një veprim kundërligjor duke kryer veprimtari në një institucion shëndetësor pa licencë, dhe duke mos i plotësuar as kushtet sipas ligjit për të kryer abort në atë institucion.

E mira e kësaj është që tani vendimin profesional e kanë marrë instancat profesionale, pra Oda e mjekëve. Disa herë kam kërkuar edhe në mandatin e kaluar që Odat të marrin kompetencat e tyre dhe të vlerësojnë ku janë bërë shkeljet profesionale.

Asnjë institucion privat nuk justifikohet nëse punon pa e marr licencën pavarësisht a është njoftuar nga ministria se i ka skaduar licenca. Inspektorati shëndetësor gjatë inspektimit duhet të kontrolloj edhe përputhjen e protokolleve me kuponët fiskal sepse një pjesë e madhe e këtyre institucioneve nuk i faturojnë shërbimet e tyre.

Sa i përket Ligjit për shëndetësi, duhet të lexohet në tërësi sepse Kosova asnjëherë nuk ka vuajtur për ligj por ka vuajtur për moszbatim të ligjit. Gjithashtu mos t'i etiketojmë mjekët dhe t'i paragjykojmë mjekët se nuk jemi të thirrur e sidomos kardiokirurgun ndoshta nder më të mirët në regjion dr. Mahmut Çakmak. Nëse dikush prej mjekëve apo institucioneve ka abuzuar me ligjin atëherë të presim të kryhet procesi nga institucionet përkatëse.

Kam një kërkesë për institucionet kompetente të Inspektoratit shëndetësor dhe drejtorisë për licencim se si licencohen qendrat e masazhit dhe a ofrojnë shërbime shëndetësore.

Fikrim Damka tha se dua ta ngrit një çështje të licencimit të disa profesionistëve shëndetësor të cilët e kryejnë fakultetin jashtë Kosovës, pasi të kthehen e bëjnë nostrifikimin e diplomës në Ministrinë e Arsimit, por nuk po mund të licencohen në Ministrinë e Shëndetësisë dhe ta ushtrojnë profesionin e mjekut. Kjo çështje duhet të diskutohet me Ministrinë e Arsimit dhe t' u bëhet zgjidhje sepse nuk e di në bazë të cilit legjislacion u ndalohej ushtrimi i profesionit.

Ka disa kuadro që edhe ka mungesa të këtij stafi në QKUK, dhe ata nuk po mund të punojnë.

Besa Baftiu tha se më intereson të di sa licenca ka revokuar Bordi i licencimit deri tani, a ka ndonjë institucion privat shëndetësor të cilit ju ka revokuar licenca?

Isak Shabani tha se prej fillimit të licencimit në procedura të licencimit kanë kaluar dikund 5000 institucione private shëndetësore. Aktualisht të licencuara janë 1606 institucione private shëndetësore, prej tyre 150 institucione private shëndetësore janë refuzuar, 8 janë revokuar dhe 32 janë pezulluar. Me ligj 60 ditë para skadimit të licencës, institucionet e kanë obligim me aplikuar për ri licencim, e ne e kemi aplikuar një lehtësim që për ata të cilët aplikojnë brenda afatit prej 60 ditësh ju kemi bërë lirim prej 50 % në taksën administrative. Sa i përket lajmërimit, ne nuk e kemi obligim por jemi duke hartuar një udhëzim administrativ në të cilin është parapa edhe lajmërimi me telefon.

Sa i përket institucioneve publike shëndetësore, është paraparë të hartohet plani kombëtar i akreditimit e ku pas atij plani, do të parashihen edhe standardet e cilësisë.

Uran Ismaili tha se sa i përket licencimit është bërë një punë e mirë, por ka edhe shumë për t'u bërë, duhet bërë edhe një edukim i profesionistëve shëndetësorë se nuk duhen të bien në kundërshtim me ligjin. Rasti i Drenasit është një rast që është thyer ligji nga profesionisti shëndetësor së pari se pacienti nuk është regjistruar në librin e protokollit. Kjo në institucione publike nuk ndodh, të gjithë i regjistrojnë. Ne nuk do t'i mbrojmë profesionistët shëndetësorë të cilët e thyejnë ligjin dhe ata do t'i marrin dënimet që i meritojnë.

U cek edhe dëmtimi i inspektorëve shëndetësorë në ligjin e pagave, unë kam kërkuar përmes amendamentit që t'ju rritet paga inspektorëve shëndetësorë, por nuk më është aprovuar aq sa kam kërkuar, pra, kam kërkuar që paga e inspektorit shëndetësor të jetë e barabartë me mjekun specialist por nuk më është aprovuar si e plotë. Tani do të punojmë bashkërisht me inspektoratin dhe me zyrën ligjore që të gjejmë mundësi tjera për ti përkrahur inspektoratin shëndetësor.

Sa i përket paralajmërimit të institucioneve private shëndetësore jemi duke ndërtuar një sistem elektronik i cili do t'i paralajmëroi për skadim t'licencës, por të jemi real është detyrim i tyre të mos harrojnë dhe të marrin licencën.

Fatmire Mulhaxha – Kollçaku tha se përveç obligimit të ordinancave të licencohen edhe inspektorati shëndetësor të jetë më azhur dhe t'i njoftojë të gjitha institucionet që ju ka kaluar licenca.

Uran Ismaili tha se prapë mendoj se Inspektorati nuk duhet të marrë përgjegjësi, kjo barrë e ri licencimit i bie vetë institucionit që dëshiron ta vazhdojë licencën.

Sa i përket zbrazëtirave të akteve nënligjore në këtë fushë të gjitha aktet nënligjore të nevojshme do miratohen këtë vit.

Sa i përket nostrifikimit të diplomave ne do ta trajtojmë këtë temë dhe do shohim ku qëndron problematika. Do takohem edhe me ministrin e arsimit nëse është nevoja.

Ne jemi duke punuar që t'i mbajmë mjekët, por edhe t'i tërheqim mjekët që të punojnë në Kosovë. Gjithashtu duhet të shikojmë mundësit që edhe në Inspektoratin Shëndetësor të kemi të angazhuar si inspektor mjekët sepse ndryshe është e pa mundur, e kjo arrihet me angazhimin tonë që inspektoratin shëndetësor ta trajtojmë dinjiteteshëm.

Edhe preventives duhet t'i kushtohet rendësi dhe këtë vit e kemi shtuar edhe buxhetin për Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik.

Fatmire Mulhaxha thas se kisha kërkuar që mundësisht Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të përkrahet edhe me vetura.

Uran Ismaili tha se do bëjmë përpjekje dhe do t'i japim prioritet preventivës dhe do ta diskutojmë edhe me nivelin komunal për mjekësin shkollorë. Unë po bëj përpjekje që shërbimet shëndetësore të kthehen në institucionet publike. Një rast i mirë është puna e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë 24 orë.

Sa i përket mjekëve që janë nën hetime për rastin stenda, unë nuk mundëm të bëj asgjë pa përfunduar procedurat gjyqësore.

Drita Millaku tha se shqetësimi im dhe i qytetarëve është se përse mjeku që është nën hetime për keqpërdorime me stenda nuk i ndalohej të punojë.

Uran Ismaili tha se politikat shëndetësore janë të atilla që krijojnë barazi dhe ju krijojnë siguri qytetarëve.

Haxhi Avdyli tha se mendoj që ndarja e punës së mjekëve në sektorin publik dhe në sektorin privat do rregullonte shumë çështje të sektorit të shëndetësisë. Tani me një pagë dinjtoze dhe me një fond të performancës do jetë e mjaftueshëm që mjeku të punoj vetëm në sektorin publik. Nëse nuk e ndajmë punën e mjekut ose në sektorin publik ose në sektorin priva nuk do të ketë shëndetësi të mirëfilltë.

Kam edhe një pyetje për fondin e performancës a do ketë një fond të performancës për kirurgët?

Bekim Haxhiu tha se kam qenë vazhdimisht kritikues i sistemit shëndetësor sepse nuk ka funksionuar dhe pacientët janë referuar nga QKUK në institucione private e sidomos në Kardiokirurgji.

Uran Ismaili tha sistemi shëndetësor i ka pas dy ankesa konstante një nga mjekët që në vazhdimësi janë ankuar se i kemi pagat e vogla dhe pacientët të cilët nuk kanë marrë shërbime cilësore. Tani çështja e pagave të mjekëve është adresuar me ligjin e pagave, tani ka mbetur që vetëm shërbimet të rriten që pacientët të jenë të kënaqur. Sa i përket ndarjes së punës së mjekëve vetëm në publike ose vetëm në private unë jam për ta ndarë por nuk besoj se kemi hapësirë sepse këtë e ka rrëzuar Gjykata Kushtetuese.

Kryetarja falënderojmë ministrin për pjesëmarrjen dhe do kemi rastin që edhe herëve tjera ta pyesim për çështje që na interesojnë.

3. Të ndryshme.

Kryetarja tha se do të njoftohen për mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU

